



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

EKSTRAKT

**V E N D I M**  
**Nr. 223, datë 02.06.2021**

**PËR**  
**CAKTIMIN E MASËS DISIPLINORE NDAJ GJYQTARIT Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1, në nenin 147/a, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 140, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 146, pika 2, shkronja “b”, 157, pika 4, dhe 172 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 86, shkronja “e” dhe 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 104 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, shqyrtoi kërkesën për procedim disiplinor, që i përket:

**KËRKUES:** **Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z.Artur Metani.**

**SUBJEKT I PROCEDIMIT:** **Z. {...}, me detyrë gjyqtar, në Gjykatën e Apelit {...}.**

**OBJEKTI I KËRKESËS:**

1. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit **z.{...}**, me detyrë gjyqtar, në Gjykatën e Apelit {...}.
2. Propozimin për caktimin e masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”.

**BAZA LIGJORE:** Neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Nenet 104, pika 3 dhe 111 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë dëgjimore të datës 02.06.2021, në përputhje me parashikimet e neneve 142 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe dëgjoi:

- **Inspektorin e Lartë të Drejtësisë z.Artur Metani**, i cili përfundimisht kërkoi pranimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit {...}, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 104, pika 3 të

ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe caktimin ndaj tij të masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”.

## V Ë R E N:

### I. Rrethanat:

1. Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (referuar në vijim dhe si Këshilli), në datën 26.04.2021, është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj z.{...}, me detyrë gjyqtar i Gjykatës së Apelit {...}, në kohën e kryerjes së shkeljeve objekt të procedimit disiplinor<sup>1</sup>.

2. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të ligjit nr.115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, dhe nenin 138 të ligjit nr.96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, (referuar në vendim si ligji “*Për Statusin*”), për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 104, pika 3 e ligjit “*Për Statusin*”.

2.1 Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (referuar në vijim dhe si ILD) ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj tij, të masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”, të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja ”b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 104, pika 3 dhe 111 të ligjit “*Për Statusin*”.

3. Nga dosja hetimore e depozituar pranë Këshillit, rezulton se Prokuroria {...} ka regjistruar procedimin penal nr.113/2015, për veprat penale “*Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë*” dhe “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/ç e 25 të Kodit Penal. Në këtë procedim penal ka marrë cilësinë e personit nën hetim edhe shtetasit {...}, i cili, në atë kohë, ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit {...}.

4. Gjatë hetimeve paraprake nga organi i Prokurorisë, ka rezultuar se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...} ishte zhvilluar një proces gjyqësor civil midis palëve paditëse {...}, {...}, {...} dhe i paditur {...}, person i tretë {...} me objekt të padisë: “Pushim cenimi në pronësi”. Me vendimin nr.1302, datë 14.05.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor {...} ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankimi nga i padituri {...} në Gjykatën e Apelit {...}. Me vendimin nr.10-2015-387 (160), datë 18.02.2015, Gjykata e Apelit {...} ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.1302, datë 14.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...} dhe rrëzimin e padisë, si të pabazuar në ligj. Kjo çështje, në këtë gjykatë, është gjykuar nga trupi gjykues në përbërje të të cilit ka qenë dhe gjyqtari {...}.

5. Pas dhënies së këtij vendimi, shtetasi {...} ka paraqitur kallëzim penal, duke pretenduar se vendimi i Gjykatës së Apelit {...} është rrjedhojë e ndikimit të shtetasit {...}, si dhe përfitimeve

<sup>1</sup> Në kërkesën për fillimin hetimit disiplinor me Nr.1594/8prot., datë 26.04.2021, protokolluar me nr.1796 prot. datë 26.04.2021, Inspektorit i Lartë të Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor, edhe ndaj gjyqtarëve {...} dhe {...}. Me vendimet nr.199/1 dhe nr.199/2, datë 12.05.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur mbylljen e procedimit disiplinor të filluar ndaj tyre pa zhvilluar seancë dëgjimore, sipas parashikimeve të nenit 139 të ligjit “Për Statusin”.

të parregullta që kanë marrë prej tij gjyqtarët e çështjes, për të cilët pretendonte se kanë udhëtuar jashtë shtetit së bashku me palën në proces gjyqësor. Nga ana e Prokurorisë janë kryer veprimet hetimore përkatëse, mbi bazën e të cilave, është vlerësuar se krijoheshin dyshime se, gjyqtarët e çështjes, në kohën që gjykimi i kësaj çështje gjyqësore ka qenë në zhvillim e sipër, kanë përfituar nga shtetasi {...} përfitime të parregullta, me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor në favor të këtij të fundit.

6. Gjykata {...}, me vendimin nr.436, datë 12.12.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë datë 11.12.2017, me objekt caktim mase sigurimi ndaj magjistratit {...}. Në këtë vendim, në paragrafin 68 të tij, arsyetohet se: *“Në vlerësim të kësaj gjykate, fakti që shtetasi {...}, ... me cilësinë e gjyqtarit të çështjes, kanë pasur komunikime telefonike me shtetasin {...}, i cili ka qenë palë në çështjen që po gjykohej prej tyre, si dhe fakti që ekzistojnë dyshime të arsyeshme se shtetasit {...}... mund të kenë udhëtuar me shtetasin {...} për në Romë Itali, në datat 2 dhe 5.10.2014 dhe në Spanjë, në datat 24 dhe 26 .10.2014, .....nuk krijojnë dyshime të arsyeshme që, ato, si gjyqtarë të kenë marrë përfitime dhe favore të parregullta nga shtetasi {...}, duke iu paguar ky i fundit biletat e udhëtimit dhe faturat e qëndrimit në hotel, por është një provë që tregon se gjyqtarët {...}, .... mund të ketë shkelur Kodin Etik të gjyqtarëve, konkretisht nenet 1,3 dhe 15 të tij, të cilat parashikojnë se, gjyqtari duhet të sillet me dinjitet dhe paanësi, si gjatë veprimitarisë gjyqësore ashtu edhe jashtë kohës së punës, si dhe duhet të shmang takimet ose kontaktet “exparte” apo jashtëgjyqësore me njërën ose të gjitha palët e gjykimit që ai gjykon, ashtu siç ka dyshime të arsyeshme se ka ndodhur në rastin konkret”.*

7. Me Urdhrin nr.3809/1prot, datë 09.01.2018 të Kryeinspektorese së ish-Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është çmuar me vend verifikimi i informacionit, të përcjellë nga Prokuroria {...}, me marrjen e të dhënave shtesë, dhe në vijim me vendimin nr.3809/10 prot., datë 17.01.2018, është vendosur fillimi i hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit {...}, për shkelje të rëndë të etikës gjyqësore, parashikuar nga neni 140/2, shkronja a) e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

8. Në vijim, Prokuroria {...} ka përcjellë vendimet për marrjen të pandehur dhe njoftimin e akuzës, ndër të cilët, edhe për gjyqtarin {...}, për kryerjen e veprës penale *“Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”*, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319/ç e 25 të Kodit Penal<sup>2</sup>.

9. Me vendimin nr.23, datë 09.02.2018, ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur pezullimin përkohësisht nga ushtrimi i detyrës të gjyqtarit {...}, për shkak të marrjes së tij si i pandehur nga Prokuroria {...}. Kundër këtij vendimi nuk është ushtruar ankim.

10. Referuar objektit të hetimit disiplinor, të filluar për shkelje të etikës gjyqësore, me vendimin nr.3809/28 prot., datë 20.03.2018 të Kryeinspektorese është vendosur pezullimi i hetimit disiplinor deri në dhënien e vendimit të formës së prerë nga organi procedues për akuzën penale të ngritur.

<sup>2</sup>Shkresa nr. 1150 prot, datë 05.02.2018, regjistruar në IKLD-së me nr.3809/19 prot datë 06.02.2018.

11. Praktika e mësipërme në gjendje të pezulluar, i është përcjellë nga Këshilli, Zyrës së ILD-së, me krijimin e saj. Gjatë shqyrtimit të praktikave nga ana e ILD-së, është konstatuar se me vendimin gjyqësor nr.69, datë 29.10.2019 të Gjykatës {...}, ndër të tjera, është vendosur:

*“1.1 Deklarimi fajtor i të pandehurit {...}për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 3 vjet burgim.*

*1.2. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin përfundimtar të të pandehurit {...}me 2 vjet burgim.*

*1.3. Në mbështetje të nenit 30/1, 35/1 dhe 44/2 të Kodit Penal, heqjen e të drejtës për të pandehurin {...}për të ushtruar funksione publike, për 5 vjet, zbatimi i të cilës fillon pas vuajtjes së dënimit me burgim....”.*

12. Mbi bazë ankimi, Gjykata {...} me vendimin nr.19, datë 21.09.2020, në lidhje me magjistratin {...}, ka vendosur:

*“1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 69, datë 29.10.2019 të Gjykatës {...}.*

*3. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim nr. 69, datë 29.10.2019, të Gjykatës {...} për të pandehurin {...}, duke vendosur në afat prove prej 4 vjetësh, me kusht që të mos kryejë vepër tjetër penale, duke mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës. ...”.*

13. Në kushtet kur konstatoi se kishte rënë shkak i pezullimit, me vendimin nr. 2591/5, datë 24.02.2021, ILD ka vendosur vazhdimin e hetimit disiplinor të pezulluar dhe për sa u parashtrua, me vendimin nr.2591/5, datë 24.02.2021, ka ndryshuar objektin e hetimit disiplinor nga shkelje të rënda të etikës gjyqësore, të parashikuara nga neni 140 pika 2 shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkeljen disiplinore për shkak të kryerjes së një krimi, për të cilin secili subjekt i proceduar është dënuar me vendim të formës së prerë, të parashikuara në nenin 140 pika 2 shkronja “b” të Kushtetutës dhe nenin 104, pika 3 e ligjit “Për Statusin”.

14. Gjatë hetimit disiplinor është kërkuar informacion pranë Këshillit, mbi statusin aktual të secilit subjekt të hetimit disiplinor. Sipas informacionit, të vendosur në dispozicion për magjistratin {...}, ka rezultuar se me kërkesën e tij me objekt “Heqjen dorë nga detyra e gjyqtarit dhe mbarimi i statusit të magjistratit”, drejtuar Këshillit, ai ka kërkuar miratimin e dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit si të bazuar në nenet 64, pika 1, shkronja “a” dhe 65 të Ligjit “Për Statusin” si dhe duke konstatuar edhe mbarimin e statusit të magjistratit. Me vendimin nr.69, datë 01.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur: “Pezullimi i shqyrtimit të kërkesës së dorëheqjes së magjistratit z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit {...}, deri në përfundim të hetimit dhe/ose procedimit disiplinor”.

## **VI. Vlerësimet dhe Konkluzionet e Këshillit:**

41. Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Gjykata {...}<sup>3</sup> ka theksuar se parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës, kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat ndërsa japin drejtësi, tu nënshtrihen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve<sup>4</sup>. Bazuar në parashikimet kushtetuese pushteti gjyqësor, përveç pavarësisë së jashtme (*pavarësia nga pushtetet e tjera*), ka edhe një pavarësi të brendshme (*gjyqtarët i nënshtrihen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve*)<sup>5</sup>.

42. Nga ana tjetër, në nenin 147, pika 1 të Kushtetutës, parashikohet si organ kushtetues Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili siguron jo vetëm pavarësinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, por dhe përgjegjshmërinë e tij. Në kuadër të kësaj fryme, Kushtetuta ka parashikuar se gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, por, ai nuk përjashtohet nga përgjegjësia në rastet e dhënies qëllimisht të një vendimi gjyqësor, si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi.

43. Përveç organeve të reja të qeverisjes së sistemit gjyqësor, ndryshimet e fundit kushtetuese parashikojnë dhe krijimin e Inspektorit të Lartë i Drejtësisë, si organi kushtetues përgjegjës, për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve si dhe për inspektimin e gjykatave të të gjitha niveleve, brenda kufijve të të drejtave dhe procedurës së parashikuar në ligj.

44. Dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore përcaktojnë, pa asnjë dyshim, në mënyrë të ndarë fazat e procesit disiplinor ndaj gjyqtarëve, të cilat janë hetimi disiplinor, i cili realizohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe procedimi disiplinor, i cili do të shqyrtohet dhe vendoset vetëm nga Këshilli, si një organ vendim-marrës kolegjal.

45. Neni 140 i Kushtetutës parashikon se gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. Në këtë zbatim të këtij parashikimi kushtetues është miratuar ligji “*Për Statusin*”, i cili normon parimet e procedimit disiplinor, llojet e shkeljeve dhe të masave disiplinore që mund të caktohen ndaj magjistratit, si dhe procedurat hetimore dhe disiplinore që ndiqen ndaj tij nga ILD dhe Këshilli.

46. Bazuar në këto dispozita kushtetuese dhe ligjore, Këshilli vlerëson se një masë disiplinore ndaj një gjyqtari duhet të jepet, gjithnjë dhe vetëm, në kuadër të një procedimi disiplinor, të filluar nga organi kompetent, dhe të shqyrtuar sipas procedurave të parashikuara në ligjin “*Për Statusin*”, në funksion të garantimit të një procesi të rregullt ligjor dhe të parimeve të procedimit disiplinor të tilla si: parimi i ligjshmërisë, akuzës, barazisë para ligjit, prezumimit të pafajësisë, proporcionalitetit etj.

47. Nga provat e administruara, rezulton se me vendimin nr.3809/10 prot., datë 17.01.2018 të Kryeinspektorese së ish-Inspektoratit të KLD-së, është vendosur fillimi i hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit {...}, për shkelje të rënda të etikës gjyqësore, parashikuar nga neni 140/2, shkronja a) e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për veprime të kryera në muajin Tetor 2014. Në kohën e kësaj vendimmarrje, Këshilli konstaton se kanë qenë në fuqi dispozitat kushtetuese të ndryshuara me ligjin nr.76/2016 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë*

---

<sup>3</sup>Shih vendimin nr. 5, datë 16.02.2012 të Gjykatës {...}.

<sup>4</sup>Neni 145, pika 1 e Kushtetutës – “*I. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrihen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve...*”

<sup>5</sup>Shih vendimin nr. 40, datë 07.07.2014 të Gjykatës {...}.

21.10.1998, *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar*<sup>6</sup>. Konkretisht, në parashikimet e pikës 2, shkronja a) të nenit 140 të Kushtetutës, dispozitë aktualisht në fuqi, vendoset shkarkimi i gjyqtarit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, kur ai është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

48. Nga ana tjetër, Këshilli konstaton se në kohën e kryerjes së veprimeve, të konsideruara si shkelje disiplinore, kanë qenë në fuqi parashikimet e ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, "*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. Sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 2 të këtij ligji, sanksionoheshin si shkelje shumë të rënda disiplinore të gjitha ato akte dhe sjellje, të cilat diskreditonin rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Në shkronjën d) të këtij neni parashikohej si një shkelje e një rëndësie të tillë dhe përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat i jepeshin magjistratit për shkak të detyrës. E njëjta shkelje parashikohet si e tillë, si në ligjin 96/2016, ashtu dhe në ligjin 48/2019, në nenin 103, shkronja d), të secilit prej tyre. Parashikimet ligjore të neneve 101-104 të ligjit nr. 96/2016 janë shfuqizuar me vendimin nr.34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese, si rrjedhojë ato nuk kanë qenë në fuqi në kohën e fillimit të hetimit disiplinor.

49. Me marrjen e cilësisë si të pandehur të magjistratit {...}dhe më pas pezullimin e tij nga ushtrimi i detyrës, me vendimin nr.3809/28prot., datë 20.03.2018 të Kryeinspektorese së ish-Inspektoratit të KLD-së, është vendosur pezullimi i hetimit disiplinor deri në dhënien e vendimit të formës së prerë nga organi procedues, pezullim i cili ka vijuar deri në datë 24.02.2021, kohë në të cilën ILD ka vendosur vazhdimin e hetimit disiplinor të pezulluar.

50. Ndërkohë, çështja penale në ngarkim të magjistratit {...}kishte përfunduar me dhënien e vendimit nr. 69, datë 29.10.2019 të Gjykatës {...}, lënë në fuqi nga Gjykata {...}, me vendimin nr. 19, datë 21.09.2020, duke u deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsionit pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*", të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe është dënuar, përfundimisht, me dy vjet burgim<sup>7</sup>. Në këtë moment, Këshilli konstaton se kishin hyrë në fuqi dispozitat e ligjit nr.48/2019 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"*<sup>8</sup>. Konkretisht, në nenin 104 të këtij ligji përcaktohen shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale. Sipas pikave 1 dhe 3 të këtij neni sanksionohet se shkelje disiplinore do të konsideroheshin veprimet, mosveprimet ose sjelljet, për të cilat magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, rast në të cilin, jepet vetëm masa disiplinore e shkarkimit nga detyra duke zbatuar, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e ligjit "*Për Statusin*" për aq sa është e nevojshme.

51. Mbi këtë kuadër ligjor, nga ana e ILD, në datë 24.02.2021<sup>9</sup>, është vendosur edhe ndryshimi i objektit të hetimit disiplinor nga shkelje të rënda të etikës gjyqësore, të parashikuar nga neni 140

<sup>6</sup>Botuar në Fletoren Zyrtare nr.138, datë 27 korrik 2016.

<sup>7</sup>Gjykata {...}, me vendimin Nr.19, datë 21.09.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 69, datë 29.10.2019 të Gjykatës {...}, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit me burgim dhe vendosur magjistratin në afat prove prej 4 vjetësh, me kusht që të mos kryejë vepër tjetër penale dhe duke mbajtur kontakte me shërbimin e provës.

<sup>8</sup>Botuar në Fletoren Zyrtare nr.116, datë 6 Gusht 2019.

<sup>9</sup>Vendimi nr.2591/5, datë 24.02.2021 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

pika 2 shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkeljen disiplinore për shkak të kryerjes së një krimi për të cilin magjistrati {...}rezulton i dënuar me vendim të formës së prerë, shkelje e parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës dhe nenin 104, pika 3 e ligjit “Për Statusin”. Në përfundim të hetimit disiplinor, nga ana e ILD, në datë 26.04.2021, është vendosur fillimi i procedimit disiplinor, me dërgimin në Këshill të kërkesës, raportit të hetimit dhe të dosjes hetimore, sipas parashikimeve të neneve 133, pika 3 dhe 138, pika 1 të ligjit “Për Statusin”.

52. Referuar gjendjes së fakteve dhe parashikimeve ligjore në fuqi, si në kohën e kryerjes së shkeljeve ashtu dhe marrjes së vendimit formë të prerë, si dhe parashikimeve të nenit 172, pika 3 dhe 4 të Ligjit “Për Statusin”, Këshilli vlerëson se në kushtet kur shkeljet disiplinore të kryera nga magjistrati {...}, kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të dispozitave të ligjit “Për Statusin” si dhe të ndryshimeve të dispozitave kushtetuese me ligjin nr. 76/2016, dhe parashikohen si të tilla si në kohën e kryerjes së tyre, si dhe përbëjnë njëkohësisht shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së një krimi, do të gjejnë zbatim përcaktimet e nenit 104 të ligjit “Për Statusin”, si dhe të nenit 140 të Kushtetutës.

53. Kushtetuta, në pikën 2 të nenit 140 të saj, e ka lidhur shkarkimin e gjyqtarit me dy kategori shkeljesh:

- shkeljet e rënda profesionale ose etike, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe,
- kryerjen e një krimi, për të cilin gjyqtari është dënuar me vendim të formës së prerë.

53.1 Referuar pikës 1 e këtij neni, vendoset përgjegjësia disiplinore me ligj e gjyqtarit, duke ia lënë ligjvënësit kompetencën e përcaktimit të veprimeve ose mosveprimeve që konsiderohen si shkelje disiplinore. Me miratimin e ligjit “Për Statusin” u individualizuan shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale, në nenin 104 të tij. Në vendimin për shfuqizimin e nenit 104, Gjykata {...} ka argumentuar se ligjvënësi, kishte parashikuar raste të tjera shkarkimi, në mungesë të delegimit të shprehur të nenit 140 të Kushtetutës, duke cenuar kështu nenin 116 të saj.

54. Nisur nga kuadri ligjor në fuqi në kohën e kryerjes së shkeljes, Këshilli vlerëson se ekzistenca e shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji, në tërësi, apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre, duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme<sup>10</sup>, kërkesë, e cila lidhet me parimin e sigurisë juridike. Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë, në mënyrë më të hollësishme, të drejtat dhe garancitë e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi ai mund të vendosë edhe kufizime, por këto kufizime duhet të bëhen vetëm për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve, me mënyra dhe forma, që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e së drejtës dhe garancitë<sup>11</sup>.

---

<sup>10</sup>Shih vendimin nr. 9, datë 26.02.2007; nr. 40, datë 07.07.2014 të Gjykatës {...}.

<sup>11</sup>Shih vendimet nr. 40, datë 07.07.2014; nr. 11, datë 06.03.2014; nr. 9, datë 26.02.2007; nr. 11, datë 04.04.2007; nr.36, datë 15.10.2007; nr. 26, datë 02.11.2005; nr. 34, datë 20.12.2005 të Gjykatës {...}

55. Nga analiza në tërësi e përmbajtjes së këtyre normave ligjore, Këshilli vëren se ngritja në nivel kushtetues e shkeljeve që sjellin si pasojë shkarkimin e gjyqtarit nga detyra në nenin 140 të Kushtetutës, është bërë nga ligjvënësi për shkak të rëndësisë që ka për magjistratin, nën aspektin e pasojës që sjell kjo shkelje disiplinore. Si e tillë ajo plotëson kërkesat për qartësi, qëndrueshmëri, besueshmëri dhe efektivitet dhe gjen zbatim të drejtpërdrejtë, pavarësisht ekzistencës apo ajo të parashikimeve ligjore përkatëse.

56. Shqyrtimi i procedimit disiplinor në Këshill, në këto raste, me anë të zhvillimit të seancës dëgjimore, ka si qëllim verifikimin e ekzistencës së shkeljes, duke respektuar procedurat disiplinore të parashikuara në ligj. Në rast se provohet ekzistenca e kryerjes së një krimi nga ana e gjyqtarit të proceduar, për të cilin ai është dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, neni 140, pika 2, shkronja b) i Kushtetutës dhe neni 111 i ligjit “Për Statusin”, parashikojnë dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pa i lënë diskrecion Këshillit, për të vlerësuar dhënien e një mase tjetër disiplinore më të lehtë, në zbatim të parimit të proporcionalitetit.

57. Gjatë seancës dëgjimore rezultoi e provuar se me vendimin Nr.69, datë 29.10.2019 të Gjykatës {...}, lënë në fuqi me vendimin Nr.19, datë 21.09.2020 të Gjykatës {...}, gjyqtari {...} është dënuar për kryerjen e veprimeve të kundërligjshme, duke u konsumuar nga ana e tij, elementët e figurës së veprës penale të “Korrupsionit pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuara nga neni 319/ç i Kodit Penal. Kjo veprë penale, duke u nisur nga formulimi i dispozitës së posaçme dhe për nga natyra e sanksionit penal apo masës së dënimit që parashikohet, kategorizohet nga Kodi Penal si krim<sup>12</sup>.

58. Vendimi gjyqësor i dhënë ndaj gjyqtarit {...}, është një vendim i cili ka marrë formë të prerë, në kuptim të përcaktimeve të nenit 462, pika 3, shkronja b) dhe nenit 428, pika 1, shkronja a) dhe b) të Kodit të Procedurës Penale. Vendimi Nr.69, datë 29.10.2019 i Gjykatës {...} është lënë në fuqi nga gjykata përkatëse juridiksionale e apelit, me vendimin Nr.19, datë 21.09.2020, lidhur me llojin e veprës penale të kryer dhe masën e dënimit.

59. Në rastin kur shkelja disiplinore identifikohet me kryerjen e një krimi, për të cilin magjistrati është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ajo konsiderohet aq e rëndë sa e bën magjistratin të papërshtatshëm apo të padenjë për të vazhduar ushtrimin e funksionit të tij, në një masë të tillë, ku aplikimi i çdo mase tjetër më të lehtë, është konsideruar nga vetë Kushtetuta dhe ligji se nuk mund të ketë rol edukues. Në këtë rast, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra të magjistratit, mbron interesin publik, duke e larguar atë nga detyra dhe duke u kthyer për magjistratin, në një masë me natyrë përjashtuese nga sistemi gjyqësor, me karakter të përhershëm.

60. Në lidhje me gëzimin nga ana e magjistratit {...}, të statusit të gjyqtarit, Këshilli konstaton se në datë 18.01.2021 nga ana e tij është depozituar një kërkesë, nëpërmjet të cilës ka parashtruar dorëheqjen nga statusi i magjistratit. Me anë të kësaj kërkesë gjyqtari ka kërkuar të heqë dorë në

---

<sup>12</sup>Neni 1 - Ligji penal dhe ndarja e veprave penale – “Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre.- Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi.” Neni 32 i Kodit Penal - Dënimi me burgim – “Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet. Për kundërvajtje penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga pesë ditë deri në dy vjet.”



mënyrë të parevokueshme nga statusi i gjyqtarit dhe nga funksioni i gjyqtarit të Gjykatës së Apelit {...}.

61. Bazuar në nenet 139, pika 2 dhe 134, pika 1, shkronja ç) të ligjit “Për Statusin”, paraqitja e dorëheqjes së magjistratit nuk përbën shkak për mbylljen e hetimit disiplinor nga ILD si dhe për fillimin dhe vazhdimin e procedimit disiplinor, në vijim, në Këshill. Në këto kushte, Këshilli ka vlerësuar dhe vlerëson se nuk mund të deklarohet mbarimi i statusit të gjyqtarit me dorëheqje, në kushtet kur ndaj tij provohet se ka filluar një hetim disiplinor dhe është dhënë një vendim gjyqësor i formës së prerë për kryerjen e një krimi. Për këto arsye, me vendimin nr. 69, datë 01.03.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur të pezullojë shqyrtimin e dorëheqjes së magjistratit {...}deri në përfundimin e hetimit disiplinor apo procedimit disiplinor të filluar ndaj tij.

62. Sa më lart, Këshilli arrin në përfundimin se, në zbatim të parimit të ligjshmërisë dhe të parimit të mos dënimit pa ligj, rezultoi e provuar se magjistrati {...}, është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, dhe si rrjedhojë ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e “Shkarkimit nga detyra”, e parashikuar në nenin 140, pika 2, shkronja b) i Kushtetutës, neni 104, pika 3 dhe neni 111 i ligjit “Për Statusin”.

63. Në nenin 157 të ligjit “Për Statusin” parashikohet shprehimisht se: “1. Magjistrati përfiton pagë të plotë gjatë pezullimit, përveç kur parashikohet ndryshe nga përcaktimet e pikave të mëposhtme të këtij neni. 2. Nëse magjistrati dënohet për kryerjen e një vepre penale nga gjykata e shkallës së parë ose jepet masë disiplinore për një shkelje disiplinore nga Këshilli kompetent, Këshilli mund të pezullojë përfitimin e pagës deri në 50 për qind, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit, derisa të vendoset mbi çdo ankim të paraqitur në gjykatën më të lartë. 3. Nëse vendimi i dhënë nga gjykata më e lartë është në favor të magjistratit, çdo shumë e mbajtur, sipas pikës 2, të këtij neni, i kthehet menjëherë magjistratit. 4. Nëse vendimi i dhënë nga gjykata më e lartë është në disfavor të magjistratit, shumat e mbajtura, sipas pikës 2, të këtij neni, vazhdojnë të mbahen derisa çështja penale ose disiplinore, për të cilën është vendosur pezullimi i përfitimit, të përfundojë me vendim të formës së prerë.”

64. Sipas parashikimit ligjor të pikës 1 të kësaj dispozite, sanksionohet rregull i përgjithshëm se magjistrati në rastet e pezullimit të tij nga detyra vijon të përfitojë të plotë pagën si dhe përfitimet e tjera që rrjedhin nga ushtrimi i detyrës së tij. Ndërkohë, përmes parashikimeve ligjore të pikave 2 - 4 të kësaj dispozite, sanksionohen rregullat përjashtues sa i përket përfitimit nga magjistrati të pagës gjatë kohës së pezullimit. Kështu, sipas pikës 2 të dispozitës, përcaktohet mundësia e pezullimit të pagës së magjistratit nga Këshilli deri në 50 për qind, në rastet kur: a) magjistrati është pezulluar sipas nenit 151 të ligjit (pezullimi i detyruar) dhe ai dënohet për kryerjen e një vepre penale nga gjykata e shkallës së parë; b) magjistrati është pezulluar sipas nenit 152 të ligjit (pezullimi në rastet e procedimit disiplinor) dhe ndaj tij jepet masë disiplinore për një shkelje disiplinore nga Këshilli. Më tej, sipas pikës 3 të dispozitës, në rastin e zbatimit të pikës 2 të saj, pra pezullimit të pagës së magjistratit nga Këshilli deri në 50 për qind, magjistratit i kthehet çdo shumë e mbajtur nëse është në favorin e tij vendimi i dhënë nga gjykata më e lartë, qoftë në kuadër të çështjes penale, ashtu dhe në kuadër të çështjes disiplinore. Nga ana tjetër, sipas pikës 4 të dispozitës, që është alternativa e kundërt e pikës 3 të saj, pezullimi i pagës së magjistratit deri në 50 për qind vazhdon nëse vendimi i gjykatës më të lartë është në disfavor të

tij. Ndërkohë, ky pezullim i pagës së magjistratit në këtë rast vazhdon deri sa çështja penale ose disiplinore të përfundojë me vendim të formës së prerë.

65. Në rastin konkret, siç dhe u parashtrua më lart, Këshilli konstaton se gjyqtari i proceduar disiplinarisht {...}, ndaj të cilit është vendosur pezullim i detyruar nga detyra, është dënuar për kryerjen e një veprë penale nga gjykata e shkallës së parë (Vendim nr.69, datë 29.10.2019, i Gjykatës {...}). Në vijim, vendimi i gjykatës më të lartë në çështjen penale kundër tij (Vendimi nr.19, datë 21.09.2020, i Gjykatës {...}), klasifikohet si një vendim në disfavor të gjyqtarit të pezulluar {...}. Dhe, përveç kësaj, referuar legjislacionit procedural penal, konkretisht nenit 462, pika 3, shkronja “b” dhe nenit 428, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të Kodit të Procedurës Penale, ky vendim i gjykatës më të lartë klasifikohet si vendim i formës së prerë.

66. Në referencë të rrethanave të faktit dhe të ligjit, si më lart cituar, Këshilli vlerëson se në kushtet kur magjistrati i pezulluar nga detyra është dënuar për kryerjen e një krimi me vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk ndodhemi para rastit të pezullimit të pagës dhe të përfitimeve të tjera deri në 50 për qind. Si rrjedhojë, Këshilli çmon se në rastin konkret jemi para zbatimit të nenit 157, pika 4, të Ligjit “Për Statusin”, në respektim të të cilit duhet të urdhërohet ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënieve financiare me gjyqtarin e shkarkuar nga detyra {...}, pra ndërprerja e trajtimit financiar sa i përket përfitimit të pagës apo edhe përfitimeve të tjera, kjo jo për shkak të dhënies së masës disiplinore, por për shkak se magjistrati është i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

67. Në lidhje me të drejtën e ankimit, Këshilli vëren se neni 147 i ligjit “Për Statusin” përcakton të drejtën e ankimit ndaj vendimeve disiplinore. Sipas këtij neni, magjistrati dhe Inspektori kanë të drejtë të ankimojnë vendimin për masë disiplinore në gjykatën kompetente. Ndërkohë, neni 140 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht se: ....4. *Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatën {...}*.” Një dispozitë e veçantë për ankimet është vendosur dhe në ligjin nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, konkretisht në nenin 100 të tij, në të cilin parashikohet se: “1. *Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi gjyqtarët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese...*

68. Në vijim të procesit të ankimit, neni 179, pika 7 e Kushtetutës parashikon shprehimisht se ....7. *Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë....*

69. Bazuar në këto dispozita ligjore, Këshilli konstaton se subjektet e këtij procedimi disiplinor kanë të drejtë të ushtrojnë ankim ndaj këtij vendimi tek gjykata kompetente, që do të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të tij për marrjen e masave disiplinore ndaj magjistratëve, që është {...}

## **PËR KËTO ARSYE:**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në 147, pika 1, në nenin 147/a, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 140, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 146, pika 2, shkronja “b” dhe 157, pika 4 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 86, shkronja “e” dhe 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 104, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

## **V E N D O S I :**

1. Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Shkarkimin nga detyra të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit {...}.
3. Ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve financiare, të pagës si dhe të përfitimeve të tjera të magjistratit {...}.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në {...}, pranë Gjykatës {...}, afat i cili fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
5. Një kopje e vendimit t’u njoftohet subjekteve të procedimit disiplinor, magjistratit {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**Zëvendëskryetar**  
**MAKSIM QOKU**

**Anëtar**  
**MEDI BICI**  
*(kundër pikës 3)*

**Anëtar**  
**ILIR TOSKA**

**Anëtare**  
**BRIKENA UKPERAJ**

**Anëtare**  
**FATMIRA LULI**

**Anëtare**  
**BRUNILDA KADI**  
*(kundër pikës 3)*

**Anëtare**  
**MARÇELA SHEHU**  
*(kundër pikës 3)*

**Anëtar**  
**ERJON MUHARREMAJ**

**Anëtar**  
**ALBAN TORO**  
*(kundër pikës 3)*

**Anëtar**  
**DRITAN HALLUNAJ**